

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	“Për ndryshimet klimatike”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
FAZAE POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm dhe transponon pjesërisht Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Europian
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva 2003/87/EC të Parlamentit Europian
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Draft Dokumenti i Strategjisë Kombëtare dhe Planeve të Veprimit për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP)”.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	04.04.2017
DATAE VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Qershor 2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 15.7.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MTM- Nr. 02
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Eneida Rabdishta, Specialiste në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit e-mail-i: Eneida.Rabdishta@turizmi.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJEEKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Ndryshimet klimatike janë një nga kërcënimet më të mëdha që ndikojnë negativisht në sigurinë kombëtare të Shqipërisë duke kontribuar në rritjen e fatkeqësive natyrore, nivelin e lartë të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, konfliktet mbi mbi resurset bazë etj. Për parandalimin e efekteve negative që sjellin ndryshimet klimatike është i nevojshëm hartimi i një kuadri politikash dhe legjislacioni në përputhje me politikat e ndryshimeve klimatike të Bashkimit Evropian; i cili do të bëjë të mundur përfshirjen e ndryshimeve klimatike në politikat dhe planet e të gjithë sektorëve që kanë impakt në emetimin e gazeve serrë.	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?</i> Qëllimi i politikës është të zvogëlojë emetimet e karbonit duke integruar masat ndaj ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar dhe lokal Objektivat:	

- Reduktimi i emetimeve të dioksidit të karbonit me 11.5 % të krahasuar me skenarin bazë gjatë viteve 2016 dhe 2030.
- Menaxhimi, zhvillimi, zbatimi dhe rregullimi i mekanizmave për të përmirësuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë.
- Nxitja për përdorimin e teknologjive me karbon të ulët, të cilat do të përmirësojnë efikasitetin, të ulin emetimet, dhe të marrin teknologji që mbështesin karbonin e ulët dhe zhvillimin e qëndrueshëm të klimës;
- Përcaktimi i stimuljeve dhe detyrimeve për sektorin privat për zhvillimin e qëndrueshëm të klimës me karbon të ulët;

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikave janë shqyrtuar disa opsione.

Opsioni 0 (*status quo*): - nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re;

Opsioni 1: Hartimi i aktit ligjor për ndryshimet klimatike

Opsioni 2: Nderrmarrja e një fushate komunikimi dhe ndërgjegjësimi për operatorët e biznesit

Opsioni i preferuar është Opsioni 1: - Hartimi i aktit ligjor për ndryshimet klimatike.

Avantazhet: Përfitimet nga zbatimi i Aktit për Ndryshimet Klimatike përfshijnë zvogëlimin e rrezikut të pasojave të rënda të ndryshimeve klimatike, përmirësimin e koordinimit ndërmjet sektorëve dhe niveleve të qeverisjes, krijimi i një kuadri institucional që mundëson drejtimin strategjik për ndryshimet klimatike në nivelet më të larta, përmirësimin e monitorimit dhe raportimit, dhe përmirësimin e qasjes ndaj financimeve për klimën.

Referuar tabelës “Matrica e performancës” rezulton se Opsioni 1 (Hartimi i aktit ligjor për ndryshimet klimatike) merr pikët maksimale, pasi ky opsion bën të mundur plotësimin e kriterëve bazë të kësaj politike për zvogëlimin e rrezikut të pasojave të rënda të ndryshimeve klimatike.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Akti për ndryshimet klimatike kërkon ndërmarrjen e veprime në sektorët shtetëror që impaktohen në nivel kombëtar dhe në nivel lokal duke identifikuar qartë ndryshimet klimatike si një çështje ndërsektoriale. Kjo qasje ngre ndryshimet klimatike në një çështje ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke pranuar se nuk janë thjesht një çështje mjedisore. Njohja e ndryshimeve klimatike si një çështje ekonomike dhe sociale është e dobishme për të përmirësuar prioritetet për qëllime të përshtatjes, zbutjes dhe financimit, dhe për të inkurajuar zbatimin e veprimeve në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar do të përfshijnë kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik dhe bizneset. Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik dhe privat përfshijnë kosto administrative.

Ndikimi mjedisor i drejtpërdrejtë pritet të jetë pozitiv, pasi do të sjellë reduktimin e emetimeve të gazrave serrë; fushata pyllëzimesh; përmirësimin e cilësisë së ajrit

Ndikimi social i drejtpërdrejtë pritet të jetë pozitiv pasi mund të ndikojë në përmirësimin e

shëndetit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur Opsioni 1. Opsioni 1 është opsioni i vetëm që do ti hapë rrugën hartimit të akteve ligjore/nënligjore në këtë fushë si një kërkesë e kohës. Sot ka një thirrje të përgjithshme në nivel ndërkombëtar për të përgatitur kuadrin ligjor për çështje të klimës. Gjithashtu do të reduktojë emetimet e karbonit dhe pritët të përmbushë objektivat e politikave në mënyrë më efikase në krahasim me opsionet e tjera.

Efektet financiare për buxhetin e shtetit janë të menjëhershme dhe kostot për 3 vitet e para të zbatimit, janë të parashikuara në dokumentat e PBA 2020-2022 të institucioneve përgjegjëse.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
7,576,343	22,357,292	25,771,336

KONSULTIMI

Jepni një përmblendhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Procesi i konsultimit për përgatitjen e projektligjit është kryer nëpërmjet një sërë takimesh për mbledhjen e informacionit dhe njohjen me metodologjinë e punës dhe ëorkshop-et për prezantimin e versioneve të ndryshme të projektligjit, të përgatitura me konsulencën e projektit të Bashkimit Europian, IBECA. Pas çdo ëorkshop-i, Ministrinë kryesore të linjës ishin të ftuara të dërgonin komentet/kontributet e tyre me shkrim, të cilat janë marr parasysh gjatë hartimit të draftit final.

Më 24.01.2017 është publikuar njoftimi ne faqen zyrtare

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/27> dhe nuk ka patur asnje koment.

Në 28 shkurt 2017 Projekti IBECA në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, organizoi prezantimin dhe diskutimin e projektligjit për “Ndryshimet Klimatike” në Hotel Tirana. Në takim morën pjesë përfaqësues nga ish Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bashkia e Tiranës, AKBN, STKKU, OJQ dhe kompanitë private.

Disa nga komentet e grupeve të interesit ishin:

1. Në lejen Mjedisore të specifikohen shkarkimet e secilit instalim pavarësisht se cilit ato i përkasin. Leja mjedisore mohohet në rast se shumatorja e shkarkimeve tejkalon nivelin e pragut
2. Te ndahet puna politike nga ajo teknike.
3. INSTAT të konfirmojë të dhënat për energjinë. INSTAT duhet të krijojë të dhënat nga poshte lart. Te bëjë edhe survejime për të dhënat nga poshte lart. Burimi ligjor i të dhënave të mos jete AKBN por INSTAT.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen sipas përcaktimeve të dispozitave të aktit për “ndryshimet klimatike”, si dhe zbatimi i tij do të plotësohet dhe do të bëhet më i mundur me miratimin e akteve nënligjore që do të miratohen në zbatim të këtij akti.

Ky projekt akt parashikon Agjencinë Kombëtare të Mjedisit si institucioni që lëshon lejen e mjedisit që përfshin shkarkimet e GES-it për të gjithë apo për një pjesë të instalimit, nëse operatori është në gjendje të demonstrojë se ka marrë masat e nevojshme, që të monitorojë dhe raportojë shkarkimet e GES-it, sipas kërkesave të rregullores, referuar këtij akti.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit vendos kushtet që lidhen me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES, në aktin e miratimit për lejen e mjedisit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit në fuqi për lejet e mjedisit.

Ministritë e linjës dhe bashkitë hartojnë politika që e nxisin sektorin publik dhe privat për investime të konsiderueshme që shkarkojnë pak GES, janë transparente, kanë rezultate të parashikueshme, janë pak të ndikueshme nga ndryshimet klimatike dhe inkurajojnë ndërmarrjet, institucionet, grupet sociale dhe individët, për të ndjekur dhe për t’iu përshtatur progresit dhe inovacionit teknologjik, zbatimit të rezultateve të shkencës dhe teknologjisë, zhvillimit të arsimit dhe industrisë, në zbatim të kërkesave të këtij ligji.

Bazuar në Kontributin Kombëtar të Pikësnyuar (INDC) Shqipëria është angazhuar të reduktojë emetimet e dioksidit të karbonit me 11.5 % të krahasuar me skenarin bazë gjatë viteve 2016 dhe 2030.

Mënyra e raportimit, për subjektet që do të impaktohen nga ky ligj dhe pjesë të lejes së tyre të mjedisit kanë detyrim raportimin mbi gazet serrë, do të raportojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit 1 herë në vit.

Në funksion të opsionit të preferuar do të hartohet Vendimi i Këshillit të Ministrave mbi një mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazit dhe raportimin e informacioneve të tjera në nivel kombëtar dhe të Bashkimit Evropian lidhur me ndryshimet klimatike

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ky projektligj është përgatitur në përputhshmëri të pjesshme me Direktiven 2003/87/EC që përcakton një skemë për tregtimin e lejeve për shkarkim të gazeve serrë brenda Komunitetit dhe Rregullores 525/2013/EC për ngritjen e një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve serrë dhe të çështjeve të tjera që lidhen me klimën në nivel kombëtar.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.

Shqipëria ka njohur mjaft ndryshime dhe zhvillime të rëndësishme në fushën e mjedisit, veçanërisht në sektorin e ndryshimeve klimatike.

Bazuar në Kontributin Kombëtar të Pikësnyuar (INDC) pranë Sekretariatit të UNFCCC-së në 24 shtator 2015, dhe Marrëveshjes së Parisit Shqipëria si një vend me ekonomi të dekarbonizuar, është angazhuar të reduktojë emetimet e dioksidit të karbonit me 11.5 % të krahasuar me skenarin bazë gjatë viteve 2016 dhe 2030. Mekanizmat kryesore për arritjen e këtij objektiivi lidhen me ruajtjen e

niveleve të ulëta të emetimeve të gazeve serrë nga sektori i prodhimit të energjisë dhe zhvillimin e politikave me karbon të ulët për të mos lejuar rritjen e gazeve serrë nga sektorë të tjerë të ekonomisë.

Identifikoni shkaqet e problemit:

Shkaqet kryesore të këtij problemi janë:

- Buxhet i ulët për monitorimin e situatës;
- Mbivendosje e fushave të përgjegjësisë midis institucioneve
- Mungesa e programeve të edukimit në vazhdim dhe trajnimet, në fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike

Përshkruani shtrirjen e problemit.:

Problemi shtrihet në nivel kombëtar,. kryesisht ne sektorët e energjisë, bujqësisë, transportit, ndryshimit të përdorimit të tokës, ndotjes.

Grupet e interesit të cilat do të impaktohen nga ky ligj dhe do të kenë detyrim të raportojnë për emetimet e gazeve serrë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit janë listuar si më poshtë:

No	Country code	Operator	Thermal Installation	Address
1	AL-0001.001	Vlora Thermal Poër Plant Combines Cycle: actually at comissioning stage	85 MW	Vlora TEC sh.a. Pylli i Vlores, Vlore-Albania
2	AL-0001.002	Vlora Thermal Poër Plant Combines Cycle: actually at comissioning stage	85 MW	Vlora TEC sh.a. Pylli i Vlores, Vlore-Albania
3	AL-0001.003	Vlora Thermal Poër Plant Combines Cycle: actually at comissioning stage	60 MW	Vlora TEC sh.a. Pylli i Vlores, Vlore-Albania
4	AL-0002.001	Fier Thermal Poër Plant: actually not in the èorking stage	51 MW	TEC Fierit, Zona Industriale, Fier-Albania
5	AL-0002.002	Fier Thermal Poër Plant: actually not in the èorking stage	51 MW	TEC Fierit, Zona Industriale, Fier-Albania
6	AL-0002.003	Fier Thermal Poër Plant: actually not in the èorking stage	86 MW	TEC Fierit, Zona Industriale, Fier-Albania
7	AL-0002.004	Fier Thermal Poër Plant: actually not in the èorking stage	86 MW	TEC Fierit, Zona Industriale, Fier-Albania
8	AL-0002.005	Fier Thermal Poër Plant: actually not in the èorking stage	86 MW	TEC Fierit, Zona Industriale, Fier-Albania

9	AL-0002.006	Fier Thermal Power Plant: actually not in the working stage	180 MW	TEC Fierit, Zona Industriale, Fier-Albania
10	AL-0003.001	Antena Cement sh.a. Titan Group;	> 500 tonnes per day	Boka e Kuqe, Fushe-Kruje, Kruje-Albania
11	AL-0003.002	Antena Cement sh.a. Titan Group;	28 MW	Boka e Kuqe, Fushe-Kruje, Kruje-Albania
12	AL-0003.003	Antena Cement sh.a. Titan Group;	28 MW	Boka e Kuqe, Fushe-Kruje, Kruje-Albania
13	AL-0003.004	Antena Cement sh.a. Titan Group;	28 MW	Boka e Kuqe, Fushe-Kruje, Kruje-Albania
14	AL-0004.001	Millis Bricks sh.a.;	22 MW	Koder Derven, Fshati Derven, Fushe Kruje
15	AL-0005.001	ARMO - Uzina e Perpunimit te Naftes (UPN);	9.3 MW	Komuna Qender - Fier, Fshati Drize
16	AL-0005.002	ARMO - Uzina e Perpunimit te Naftes (UPN);	2.9 MW	Komuna Qender - Fier, Fshati Drize
17	AL-0005.003	ARMO - Uzina e Perpunimit te Naftes (UPN);	9.1 MW	Komuna Qender - Fier, Fshati Drize
18	AL-0005.004	ARMO - TEC Ballsh;	14 MW	Komuna Qender - Fier, Fshati Drize
19	AL-0005.005	ARMO - TEC Ballsh;	14 MW	Komuna Qender - Fier, Fshati Drize
20	AL-0006.001	EDIL PARCK SH.A.;	10 MW	Lagjia 15; Porto Romano, ish Nish Kimikja, Durres
21	AL-0006.002	EDIL PARCK SH.A.;	8 MW	Lagjia 15; Porto Romano, ish Nish Kimikja, Durres
22	AL-0007.001	EURO'S CONCIERIA;	6.5 MW	Bashkia Sukth, Durres
23	AL-0008.001	Grumbulluesi shpk;	5.5 MW	Ish Zona Industriale KORCE
24	AL-0009.001	SIAL PEL shpk;	10.8 Më	Fabrika e Lekures; Zona Industriale, Korce
25	AL-0010.001	SOAL shpk;	12 MW	Gorre, Komuna Kolonje, Lushnje
26	AL-0011.001	SHOQERIA VOLALBA shpk.;	26 MW	Virove, Komuna Golem, Lushnje

27	AL-0012.001	Fabrika e Prodhimit te Gelqeres sh.a.;	120 tons/day	Koder ne hyrje te Krujes
28	AL-0013.001	Aquila Group shpk;	17.5 MW	Superstrada TR-DR, km4, Kashar, Tirane
29	AL-0014.001	BI-INVESTMENT shpk;	80 tons/day	Rruga Abdul Frasheri, Pallati I Ri Jeshil 2/2, Tirane
30	AL-0015.001	EHË GmbH;	11.5 MW	Superstrada TR-DR, km4.8, Kashar, Tirane
31	AL-0016.001	HAKO shpk;	8.5 MW	Superstrada TR-DR, km 5, Kashar, Tirane
32	AL-0017.001	Selenice Bitumi sha	110 tons/day	Po Box 4326-Vlora; Albania
33	AL-0018.001	Kurum sha	60 MW	ish Kombinati Metalurgjik, Elbasan
34	AL-0019.001	Darfo Elbasan sha	25 MW	ish Kombinati Metalurgjik, Elbasan

- Vlerësimi nëse problemi mund të trajtohet apo jo me një ndryshim të politikës-

Sektori i transportit është një nga shkaktarët kryesorë për emetimin e gazrave të serrës. Në vitin 2016, emetimi i këtyre gazrave nga sektori i transportit, përfaqëson 20% të totalit të emetimit në Shqipëri. Gjatë periudhës 2000-2016, emetimi në tërësi i këtyre gazrave që vijnë nga transporti është rritur me 30%. Megjithatë, emetimi i gazeve serrë nga sektori i transportit deri më sot nuk është monitoruar dhe raportuar në mënyrë të standardizuar dhe të krahasuar. Mungesa e të dhënave të besueshme, e pengon qeverinë shqiptare nga përcaktimi i politikave të përshtatshme për të promovuar reduktimin e emetimit. Gjithashtu ajo nuk e lejon qeverinë të raportojë se si Shqipëria po kontribuon në arritjen e objektivave sipas BE për këto gazra. Ndërhyrja e qeverisë është e domosdoshme për të reduktuar mundësitë e dështimit. Në mungesë të rregullimeve për raportimin, emetuesit nuk do të raportojnë mbi emetimet vullnetare të dioksidit të karbonit. Ndërhyrja e qeverisë është gjithashtu e justifikuar nga dështimet e tregut si psh. nga faktorët e jashtëm negativë dhe klima/mjedisi si një e mirë publike globale.

Faktorët e jashtëm negativë:

Rritja e përqendrimit të gazeve serrë në atmosferë, imponon kosto te shoqëria. Megjithatë, kostoja e plotë e këtyre emetimeve nuk ka lindur nga emetuesi, duke nënkuptuar në këtë mënyrë se bizneset nuk llogarisin kostot e emetimit kur bëjnë zgjedhjen e produktit të tyre. Pa ndërhyrjen e qeverisë, incentivat ekonomike për bizneset që të ndryshojnë sjelljen e tyre, janë të vogla dhe emetimet e gazrave të serrave nuk mund të reduktohen në nivele që të jenë në përputhje me shmangien e pasojave serioze nga ndryshimet klimaterike.

Klima/mjedisi si e mirë publike globale

Ata që nuk paguajnë për klimën/mjedisin si e mirë publike globale, nuk mund të përjashtohen nga të pasurit përfitime dhe përfitimet e një personi ndaj kushteve klimatike nuk zvogëlojnë aftësinë e të tjerëve për të përfituar. Këto karakteristika jo zëvendësuese dhe jo plotësuese nënkuptojnë se pa ndërhyrjen e qeverisë, tregu nuk mund të ofrojë mbrojtjen e mjaftueshme ndaj kushteve klimatike. Anasjelltas, bizneset kanë incentivat për ta adresuar vetë çështjen në rrjedhën e lirë të tregut, pasi ata nuk mund të përjashtohen nga përfitimet. Në këtë rast, tregjet për mallra dhe shërbime që kanë një ndikim mbi mjedisin (përfshirë transportin) nuk reflektojnë pasojat e konsumatorëve të ndryshëm dhe zgjedhjeve të investimeve për klimën/mjedisin. Kjo politikë mbështet objektivat e qeverisë të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike dhe është në përputhje të pjesshme me Direktivën 2018/12/EC të BE.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*

Aktualisht nuk ka një legjislacion specifik që shërben si bazë ligjore për aktet nënligjore mbi ndryshimet klimatike, që kërkojnë herë pas here të hartohen nga UNFCCC dhe/apo BE, dhe duke vazhduar në traditën e vendosur tashmë për të patur nga një ligj kuadër për të gjitha çështjet tematike të mjedisit qëllimi i këtij akti është të krijojë bazën ligjore për integrimin e politikave dhe për masa efektive që mundësojnë:

- a. plotësimin e detyrimeve të RSH ndaj Konventës për arritjen e objektivit final të saj, përmes nxitjes së reduktimit të shkarkimeve të GES
- b. përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar dhe/ose lokal; dhe
- c. evidentimin e arritjeve të vendit në këto drejtime duke përdorur metodologji sipas modeleve të Konventës dhe të BE-së.

Nga sa MW sipër, vlerësohet se është i nevojshëm miratimi i këtij akti me qëllim:

- a) përmbushjen e rekomandimeve të BE dhe hartimin e politikave me të plota, bazuar në të dhëna konkrete dhe shkencore;
- b) Zbatimin e rekomandimeve të progres raporteve të viteve të fundit të BE-së për Shqipërinë për të arritur përafimin e plotë në fushën e mbrojtjes së natyrës;
- c) Përcaktimin qartë të organeve përgjegjëse monitorimin, raportimin e GES; hartimin e politikave dhe për të shmangur mbivendosjet në këtë proces

- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

1. Me synimin për të zvogëluar efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike dhe për të kontribuar në përgjigjen globale ndaj tyre, objektivat kombëtarë për ndryshimet klimatike në Republikën e Shqipërisë janë:
 - a) zvogëlimi i shkarkimeve antropogjene të gazeve me efekt serrë në nivel kombëtar, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare;
 - b) rritja e aftësisë për t'u përshtatur ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike, në nivel kombëtar qendror dhe vendor;
 - c) nxitja e zhvillimit ekonomik nëpërmjet krijimit të vendeve të punës dhe konkurrencës, duke përfshirë edhe diversifikimin ekonomik dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;

Një tjetër element që sot mungon dhe do të duhet të adresohet është dhe zhvillimi i kuadrit strategji dhe plane kombëtare, harmonizimi dhe integrimi i ndryshimeve klimatike në politikat kombëtare.

- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*

Ndërhyrja e qeverisë propozohet të bëhet në disa mënyra:

1. Harmonizimi dhe reflektimi i ndryshimeve klimatike në politikat kombëtare dhe ato sektoriale
2. Përcaktimi i masave nga institucionet përgjegjëse në sektorët që ndikojnë për reduktimin e gazrave sërë
3. Përcaktimi i kuadrit institucional, rregullator dhe koordinues ndërmjet institucioneve publike
4. Ndërthurjen dhe reflektimin e kërkesave dhe politikave për ndryshimet klimatike në kurrikulat e arsimit
5. Përcaktimin e kufizimeve dhe detyrimeve në sektorin privat (bizneset) dhe rregullimin e kontrollin e tregut lidhur me prodhimin, tregëtimin e produkteve dhe lëndeve të para që mund të cojnë në shkarkim të GES
6. Krijimi i një sistemi nxites financiar që krijon incentivat për sektorin privat për thellimin e kerkimit shkencor dhe aplikimin e teknologjive me më pak karbon

- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

Kjo ndërhyrje lidhet me objektivin e qeverisë drejt përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, duke synuar përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me direktivën përkatëse të paraqitura në nivel kombëtar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian.

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Paralelisht me hartimin e këtij akti po punohet edhe për harmonizimin e Rregullores 525/2013/EC së BE-së për ngritjen e një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve sërë dhe të çështjeve të tjera që lidhen me klimën në nivel kombëtar. Bashkëpunimi ndërinstitucional për zbatimin e detyrimeve të konventës dhe të Acquis rregullohet me ligj duke përcaktuar përgjegjësi të qarta për çdo institucion. Dhe ngritja e kapaciteteve reale për monitorim, raportim dhe verifikim mund të bëhet vetëm mbi baza ligjore të shëndosha.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe në kohë.*

Qëllimi i politikës është të zvogëlojë emetimet e karbonit duke integruar masat ndaj ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar dhe lokal

Objektivat:

- Reduktimi i emetimeve të dioksidit të karbonit me 11.5 % të krahasuar me skenarin bazë gjatë viteve 2016 dhe 2030.
- Menaxhimi, zhvillimi, zbatimi dhe rregullimi i mekanizmave për të përmirësuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë.
- Nxitja për përdorimin e teknologjive me karbon të ulët, të cilat do të përmirësojnë efikasitetin, të ulin emetimet, dhe të marrin teknologji që mbështesin karbonin e ulët dhe zhvillimin e qëndrueshëm të klimës;
- Përcaktimi i stimuljeve dhe detyrimeve për sektorin privat për zhvillimin e qëndrueshëm të klimës me karbon të ulët;

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0 – status quo-ja: Nëse nuk bëjmë asgjë, atëherë kjo do të thotë se institucionet e linjës nuk kanë asnjë detyrim për marrjen e masave për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, për përafrimin e legjislacionit. Sektori privat nuk do të jetë i detyruar të monitorojë sasinë e GES, përdorimin e teknologjive me karbon të ulët.

Në këto kushte, nëse nuk ndërhyjmë me masa rregullatore realizimi i objektivit të politikës është i pamundur.

Opsioni 1: Hartimi i aktit ligjor për ndryshimet klimatike

Përfitimet nga zbatimi i Aktit për Ndryshimet Klimatike përfshijnë zvogëlimin e rrezikut të pasojave të rënda të ndryshimeve klimatike, përmirësimin e koordinimit ndërmjet sektorëve dhe niveleve të qeverisjes, krijimi i një kuadri institucional që mundëson drejtimin strategjik për ndryshimet klimatike në nivelet MW të larta, përmirësimin e monitorimit dhe raportimit, dhe përmirësimin e qasjes ndaj financimeve për klimën.

Opsioni 2: Ndërmarrja e një fushate komunikimi dhe ndërgjegjësimi për operatorët e biznesit

Në momentin që vendi ynë do të jetë shtet anëtar do të ketë detyrimin e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të gazeve serrë prandaj Ndërmarrja thjesht e një fushate ndërgjegjësimi nuk mjafton për të detyruar operatorët e biznesit të raportojnë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket;*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet MW të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve MW të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*

- *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuar.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuar krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet MW të mira të përgjithshme neto tëndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Perfitimet

1. **Reduktimi i risqeve për ndryshimet klimatike:** Përfitimet e nga adoptimi i një kuadri të qarte ligjor përfshijnë zvogëlimin e rrezikut të pasojave të rënda të ndryshimi i klimës, përmirësimi i koordinimit ndërmjet sektorëve dhe niveleve të qeverisjes, krijimin e një kuadri institucional që mundëson drejtimin dhe orinetimin strategjik në ndryshimin e klimës, monitorimin dhe raportimin e përmirësuar, përmirësimin e qasjes në financimin e masave që do të çojnë në drejtim të kontrollit të efekteve të ndryshimeve klimatike si dhe rregullimet e nevojshme në treg. Veprimi për të adresuar ndryshimet klimatike në Shqipëri do të zvogëlojë rrezikun e pasojave të rënda të ndryshimeve klimatike. Sot vendi përjeton humbje të mëdha në ekonomi si rezultat i efekteve klimatike, ndryshim, i cili kontribuon në motin ekstrem, përmbytjet e vazhdueshme, dhe rritjes së nivelit të detit, etj. Projekt akti do të ndihmojë për të zvogëluar efektet negative që vijnë në produktivitetin ekonomik si pasojë e efekteve negative të klimës. Përfitimet nga veprimet rregullative, kontrolli i riskut nëpërmjet monitorimit dhe ndërhyrjeve të hershme në këto momente aktuale rrisin kostot ekonomike si pasojë e mos veprimit.
2. **Adresimi i ndryshimeve klimatike si çështje ekonomike, sociale dhe mjedisore:** Projekt akti kërkon të ndërmerren politika në secilin nivel të qeverisë (qendrore dhe vendore) për të konsideruar qartë çështjet e ndryshimeve klimatike si një çështje ndërsektoriale, por dhe të lidhur ngushtë me procesin e integritetit Evropian (harmonizim legjislativ me direktivat e BE). Kjo qasje e konsideron problemin e ndryshimeve klimatike si çështje ekonomike (efektet që shkakton në disa sektorë të ekonomisë) dhe jo vetëm si çështje mjedisore. Trajtimi i efekteve të ndryshimeve klimatike si një çështje ekonomike dhe sociale është e dobishme për të rritur prioritetin për qëllime të përshtatjes, zbutjes dhe financimit, dhe për të inkurajuar zbatimin e veprimeve në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverive në funksion të marrjes së masave për zbutjen e efekteve klimatike.
3. **Hedh bazat për të siguruar orinetim strategjik të nivelit të lartë për ndryshimet klimatike.** Akti parashikon hartimin e Dokumentit Strategjik për Ndryshimet Klimatike, i cili krijon kuadrin e përgjithshëm kombëtar për veprim ndaj ndryshimeve klimatike si dhe Planin Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Planin Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) si pjesë përbërëse e dokumentit strategjik.
4. **Përmirëson koordinimin ndërishtetëror.** Për të lehtësuar koordinimin efektiv midis të gjithë aktorëve të sektorit publik e privat dhe për të siguruar një monitorim, raportim dhe verifikim (MRV) me cilësi të lartë, në vazhdimësi dhe në kohë të të raportimeve kundrejt Konventës së Ndryshimeve Klimatike, si dhe për të trajtuar çdo masë tjetër për ndryshimet klimatike, ligji përcakton rregullimet institucionale. Me qëllim bashkërendimin e detyrave të ministrive dhe institucioneve publike/private, në përputhje me detyrimet e vendit ndaj Konventës dhe Marrëveshjes së Parisit, akti parashikon ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar për Ndryshimet Klimatike.
5. **Përmirësimi i monitorimit dhe raportimit:** Miratimi i rregulloreve për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të GES-it dhe të informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar si dhe krijimi i Sistemit Kombëtar të Inventarit të GES-it, duke përcaktuar procedurat kombëtare për grumbullimin, përpunimin, raportimin, verifikimin dhe arkivimin e të dhënave dhe informacionit të kërkuar,

i cili duhet të jetë funksional mbi baza të qëndrueshme dhe të vazhdueshme si edhe përcaktimin e organeve kompetente. Krijimi i sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V) të masave kombëtare për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike do të kontribuojë në ndjekjen e progresit në zbatimin e politikave, planeve adaptuese, ndërhyrjeve dhe investimeve të përshtatjes duke përmirësuar kapacitetin adaptues dhe duke mbështetur mirëqenien e përgjithshme të popullsisë të prekur nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.

6. **Përmirësoje qasjen në financimin e veprimeve për ndryshimet klimatike:** Qasja ndaj Fondit të Klimës së Gjellbër nëpërmjet Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar si institucioni ndërmjetës midis Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Gjellbër të Klimës. Ky akt do të ndihmojë për të pozicionuar më mirë Shqipërinë për të siguruar akses në skemat ndërkombëtare të financimit të klimës;
7. **Forcon bazat për pjesëmarrjen e publikut dhe sigurimin e demokracisë në ceshtjet e klimës.** Gjatë përgatitjes apo përditësimit të legjislacionit dhe strategjive të tyre në lidhje me klimën, duhet të garantohet pjesëmarrja e të gjithë aktorëve të interesuar, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, sektorin privat dhe publikun, sipas përcaktimeve të Konventës së Aarhusit dhe legjislacionit përkatës kombëtar. E drejta e publikut për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për mjedisin është një e drejtë e rendësishme që përcaktohet në akte ligjore të posaçme.

Ndikimet ekonomike

Efektet financiare për buxhetin e shtetit janë të menjëhershme dhe kostot për 3 vitet e para të zbatimit, janë të parashikuara në dokumentat e PBA 2020-2022 të institucioneve përgjegjëse.

Efektet financiare për NJVQV do të përcaktohen dhe do të fillojnë pas vlerësimit dhe monitorimit të parë të zbatimit të dokumentit strategjik.

Masat që do të zbatohen do të përcaktohen sipas nevojave dhe mundësive të NJVQV-ve bazuar në ndarjen zonale të tyre.

Kostot e implementimit të Dokumentit Strategjik për ndryshimet Klimatike, të përcaktuara në Planet e Veprimit, të cilat përmbledhin masat kombëtare për implementimin e Dokumentit Strategjik, përbëjnë edhe kostot e implementimit të këtij akti.

Sa i takon sektorit privat, aktualisht janë identifikuar subjektet që do të nënshtrohen lejes GES (gazet me efekte serrë). Republika e Shqipërisë, nuk është pjesë e skemës së uljes së emetimeve deri në momentin e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Në këtë këndvështrim, projekt akti parashikon ngritjen e skemës së monitorimit, verifikimit dhe raportimit të gazeve me efekt serrë brenda AKM. Kjo skemë nuk implikon krijimin e institucioneve të reja, apo shtimin e burimeve njerëzore dhe financiare.

Kostot financiare për sektorin privat do të përcaktohen pas vlerësimit dhe monitorimit të parë të zbatimit të planeve të veprimit, 4 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Në këtë periudhë do të përcaktohen gjithashtu edhe mënyrat e ndërhyrjes së shtetit (ndryshime në paketat fiskale, subvencione, etj) për të ndihmuar sektorin privat në përfshirjen graduale të standarteve të reja që parashikon ky projektligj.

Për këtë arsye është e pamundur të bëhet një vlerësim paraprak i efekteve financiare për sektorin privat në këtë moment.

Përfitimet në vlerë financiare do të përcaktohen pas vlerësimit dhe monitorimit të parë të zbatimit të planeve të veprimit, 4 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit. Por impakti pozitiv i pritshëm dhe përfitimet sociale e mjedisore nga zbatimi i këtij projektligji justifikojnë të gjitha kostot financiare për zbatimin efektiv të tij.

Ndikimet mjedisore

Deri në vitin 2050, degradimi i tokës dhe ndryshimet klimatike do të reduktojnë prodhimin e kulture me një mesatare prej 10% në nivel global dhe deri në 50% në rajone të caktuara. Degradimi i tokës në përgjithësi rrit numrin e njerëzve të ekspozuar ndaj ajrit të rrezikshëm, ndotjes së ujit dhe tokës, veçanërisht në vendet në zhvillim.

Ajri i ndotur është një nga faktorët negativ i cili shkakton probleme shëndetësore, ku shkak kryesor janë emetimet e larta të dioksideve të karbonit. Ndotja e tokës rezulton në degradimin e sipërfaqes së tokës si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Humbja e biodiversitetit: shpyllëzimi, ngrohja globale, mbipopullimi dhe ndotja janë disa nga shkaqet kryesore për humbjen e biodiversitetit..

Për këtë arsye është e nevojshme marrja e masave për parandalimin e efekteve negative që sjellin ndryshimet klimatike.

Ndikimet sociale:

Komunitetet që zhvillohen rreth prodhimit të kulturave bujqësore të ndryshme, si misri, gruri, varen nga klima për të siguruar jetesën e tyre.

Ndryshimet klimatike gjithashtu do të ndikojnë në turizmin dhe aktivitetet rekreative. Një klimë e ngrohtë dhe ndryshime në sasinë e reshjeve ka të ngjarë të zvogëlojë numrin e ditëve kur aktivitetet rekreative të dëborës si skijimi të jenë të mundura.

Një rritje e numrit të zjarreve mund të ndikojnë në aktivitete si ngjitje në mal dhe rekreacion në parqe. Plazhet mund të ndikohen nga erozioni për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe stuhive. Ndryshimet klimatike ndikojnë në migrimin e peshqve dhe kafshëve e si rrjedhojë do të ndikojnë në aktivitete si peshkimi dhe gjuetia. Komunitetet që sigurojnë jetesën përmes këtyre aktiviteteve rekreative do të impaktohen si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social, pasi modelet e turizmit fillojnë të ndryshojnë

Ky ligj do të ketë ndikim edhe në sektorin privat, ku aktualisht numerohen rreth 13 subjekte që do të impaktohen prej tij. Por duke qenë se Shqipëria nuk është ende vend anetar i BE ka detyrim vetëm të monitorojë dhe raportojë gazet me efekt serre. Si rrjedhojë operatorët që impaktohen kanë vetëm kosto administrative për llogaritjen dhe raportimin e gazeve serre.

Duhet të kihet parasysh se në shumë raste kërkesat për monitorim dhe raportim sipas Direktivës tashmë mund të jenë pjesë e drejtimit rutinë të objekteve në fjalë, sipas Direktivës së IED, Direktivës së Impiantëve të mëdha me Djegje dhe Direktivës për Incinerimin e Mbetjeve etj. udhëzimet e hartuara nga Komisioni do të bëjnë raportimin dhe monitorimin më të efektshëm dhe kosto-efektiv. Metodologjitë e monitorimit të referuara kanë një rritje të efikasitetit të koston, nga të cilat përfitojnë të dy palët operatorët dhe autoritetet kompetente.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Kriteret që tregojnë arritjen e objektivit për zvogëlimin e rrezikut të pasojave të rënda të ndryshimeve klimatike:

- Reduktimi i risqeve për ndryshimet klimatike:
- Adresimi i ndryshimeve klimatike si çështje ekonomike, sociale dhe mjedisore
- Përmirëson koordinimin ndër-institucional, monitorimin dhe raportimin
- Përmirëson qasjen në financimin e veprimeve për ndryshimet klimatike

Matrica e performancës

Kriteret	Pesha	Opsioni 0 (nuk do të ketë ndryshim /politikë të re)	Opsioni 1 (Hartimi i aktit ligjor për ndryshimet klimatike)	Opsioni 2 Nderrmarrja e një fushate komunikimi / ndërgjegjësimi për operatorët e biznesit)
Efektivitet ne Reduktimin e risqeve per ndryshimet klimatike	5	1 (5)	4 (20)	2 (10)
Aftësia për të adresuar ndryshimet klimatike si çështje ekonomike, sociale dhe mjedisore	3	1 (3)	3 (9)	2 (6)
Aftësia për të përmirësuar koordinimin ndërishtitucional, monitorimin dhe raportimit	3	1 (3)	2 (6)	1 (3)
Aftësia për të përmirësuar qasjen në financimin e veprimeve per ndryshimet klimatike	4	1 (4)	3 (12)	1 (4)
Kostot	3	3 (9)	1 (3)	2 (6)
Pikët		24	50	29

Referuar tabelës “Matrica e performancës” rezulton se Opsioni 1 (Hartimi i aktit ligjor për ndryshimet klimatike) merr pikët maksimale, pasi ky opsion bën të mundur plotësimin e kriterëve bazë të kësaj politike për zvogëlimin e rrezikut të pasojave të rënda të ndryshimeve klimatike.

Opsioni i preferuar eshte hartimi i ligjit.

Përfitimet nga zbatimi i Aktit për Ndryshimet Klimatike përfshijnë zvogëlimin e rrezikut të pasojave të rënda të ndryshimeve klimatike, përmirësimin e koordinimit ndërmjet sektorëve dhe niveleve të qeverisjes, krijimi i një kuadri institucional që mundëson drejtimin strategjik për ndryshimet klimatike në nivelet më të larta, përmirësimin e monitorimit dhe raportimit, dhe përmirësimin e qasjes ndaj financimeve për klimën.

Ky akt trajton Investimet dhe financimet e gjelbërta. Nga ministrinë e linjës kërkohet që me politikat e tyre të nxisin investime miqësore ndaj mjedisit dhe klimës, të përfshijnë sektorin privat në përpjekjet për të arritur objektivat e vendosur në politikën kombëtare për klimën, transferimin e teknologjive me pak karbon në fusha të caktuara si dhe të përfitojnë nga fondet kombëtare dhe të nxisin pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe të përfitojnë financime nga fondet ndërkombëtare për klimën.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Për të mundësuar zbatimin e këtij ligji, do të jetë e nevojshme të hartohet një numër aktesh nënligjore lidhur me sa më poshtë vijon:

Këto akte nënligjore do të përcaktojnë detajet e zbatimit. Mekanizmat institucionale që kërkohen për zbatimin e këtij ligji që përfshijnë detyrimin për raportimin vjetor të emetimeve të gazeve serrë.

Për të arritur qëllimet e politikës institucionet e linjës do të marrin masa për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike me qëllim përmbushjen e detyrimit për reduktimin e emetimeve me 11.5%.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka miratuar Dokumentin Strategjik për Ndryshimet Klimatike, i cili krijon kuadrin e përgjithshëm kombëtar për veprim ndaj ndryshimeve klimatike dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit.

Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) pjesë përbërëse e Dokumentit Strategjik do të rishikohen çdo 4 vjet.

Për rrjedhojë kostot e implementimit të ligjit, nëpërmjet Dokumentit Strategjik dhe Planeve të Veprimit përkatëse, do të rishikohen bazuar në rezultatet e monitorimit, sipas përcaktimeve në pikën 6 të po këtij neni:

Ministria, nëpërmjet Grupit Ndërmnistror të Punës në fushën e ndryshimeve klimatike, monitoron dhe vlerëson çdo 4 vjet progresin për zbatimin e dokumentit strategjik për ndryshimet klimatike dhe harton raportin, i cili përmban informacionin për:

- a) vlerësimin e progresit në reduktimin e shkarkimeve dhe përthithjes nga rezervuarët e GES-it, në raport me Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (NDC);
- b) vlerësimin e progresit në zbatimin e Planit Kombëtar të Zbutjes së Gazeve me Efekt Serrë;
- c) zbatimin e Planit Kombëtar për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike, që përfshin: gjetjet e reja dhe vulnerabilitetin mbi ndryshimet klimatike; aktivitetet e kryera gjatë procesit të NAP; progresi dhe vështirësitë në integrimin e përshtatjes në sektorët e tjerë; progresi dhe vështirësitë në arritjen e objektivave dhe indikatorëve; rekomandime për masat në të ardhmen.

Nga sa me sipër dhe sipas atyre që janë parashikuar në këtë draft-ligj, **rekomandohet që** pas monitorimit dhe vlerësimit të parë (4 vjet nga hyrja në fuqi) të implementimit të strategjisë dhe rrjedhimisht këtij draft-ligji, të rishikohet edhe vete ligji dhe të bëhet një RIA me e detajuar, e diskutuar dhe dakordësuar me të gjitha palët e interesuara.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Projektakti përcakton organet përgjegjëse për ndryshimet klimatike në vend, përmes ndarjes së qartë të përgjegjësi midis organeve/institucione qendrore e vendore dhe shmangien e mbivendosjes.

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen sipas përcaktimeve të dispozitave të aktit për “ndryshimet klimatike”, si dhe zbatimi i tij do të plotësohet dhe do të bëhet më i mundur me miratimin e akteve nënligjore që do të miratohen në zbatim të këtij akti.

Ky projekt akt parashikon Agjencinë Kombëtare të Mjedisit si institucioni që lëshon lejen e mjedisit që përfshin shkarkimet e GES-it për të gjithë apo për një pjesë të instalimit, nëse operatori është në gjendje të demonstrojë se ka marrë masat e nevojshme, që të monitorojë dhe raportojë shkarkimet e GES-it, sipas kërkesave të rregullores, referuar këtij akti.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit vendos kushtet që lidhen me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES, në aktin e miratimit për lejen e mjedisit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit në fuqi për lejet e mjedisit.

Ministritë e linjës dhe bashkitë hartojnë politika që e nxisin sektorin publik dhe privat për investime të konsiderueshme që shkarkojnë pak GES, janë transparente, kanë rezultate të parashikueshme, janë pak të ndikueshme nga ndryshimet klimatike dhe inkurajojnë ndërmarrjet, institucionet, grupet sociale dhe individët, për të ndjekur dhe për t’iu përshtatur progresit dhe inovacionit teknologjik, zbatimit të rezultateve të shkencës dhe teknologjisë, zhvillimit të arsimit dhe industrisë, në zbatim të kërkesave të këtij ligji.

Bazuar në Kontributin Kombëtar të Pikësnyuar (INDC) Shqipëria është angazhuar të reduktojë emetimet e dioksidit të karbonit me 11.5 % të krahasuar me skenarin bazë gjatë viteve 2016 dhe 2030.

Mënyra e raportimit, për subjektet që do të impaktohen nga ky ligj dhe pjesë të lejes së tyre të mjedisit kanë detyrim raportimin mbi gazet serrë, do të raportojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit 1 herë në vit.

Treguesit për të matur arritjen e qëllimeve të politikës për ndryshimet klimatike janë si më poshtë:

- a) reduktimi i shkarkimeve me 11.5 % sipas Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (NDC);
- b) Zbutja e ndikimeve të Gazeve me Efekt Serrë;
- c) Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike, që përfshin:
 - gjetjet e reja dhe vulnerabilitetit mbi ndryshimet klimatike;
 - progresi dhe vështirësitë në integrimin e përshtatjes në sektorët e tjerë;
 - progresi dhe vështirësitë në arritjen e objektivave dhe indikatorëve;
 - rekomandime për masat në të ardhmen.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale e vlerësimit të ndikimit (VAN) 3 kostot dhe përfitimet e vlerësimit të përcaktuar në										
Faktorin e ndikimit të zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.	Vlerë në total (VAN)	Kosto	Përfitim	Vlerë monetare të përcaktuar	Vlerë monetare të përcaktuar	Vlerë monetare të përcaktuar	Vlerë monetare të përcaktuar	Vlerë monetare të përcaktuar	Vlerë monetare të përcaktuar	Vlerë monetare të përcaktuar
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim <i>kosto perimplementimin e ligjit nga institucionet qendrore deri ne 2026</i>										
Kosto për biznesin – njëherë (deri në momentin që verifikimi do të jetë detyrim) për cdo subjekt do të angazhohet një person për perlllogaritjen. Në kosto përfshihet paga e një personi.										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim <i>(te ardhurave nga hyrja e vizitoreve ne Zonat e Mbrojtura)</i>										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Përfitim për buxhetin – në vazhdim *										

Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në mijë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			